

AKT THEMELIMI DHE STATUT “T.R.E 222 Construction” SHPK

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“T.R.E 222 Construction” SHPK

AKT THEMELIMI DHE STATUT “T.R.E 222 Construction” SHPK

Kreu I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Bazuar në Kushtetutë dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, **ligjin nr.9901 date 14.04.2008** “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe në **ligjin nr. 9723, date 03.05.2007** për Q.K.B (Qendra Kombëtare e Biznesit):

1. Sot më 02.09.2025 ne,

- ❖ **Kristjan Papekaj** shtetas Shqiptar, lindur me **14.05.1995 Shkoder**, banues ne Shqiperi, identifikuar me numrin e kartes se identitetit nr **J50514101V**
- ❖ **Ernest Rranzi** shtetas Shqiptar, lindur me **03.10.1981 Kac , Shkoder**, banues ne Shqiperi, identifikuar me numrin e kartes se identitetit nr **I11003032R**
- ❖ **Aleksandër Zefi** shtetas Shqiptar, lindur me **13.05.1978 , Shkoder**, banues ne Shqiperi, identifikuar me numrin e kartes se identitetit nr **H80513207F**

vendosem per te krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin:

“T.R.E 222 Construction” SH P K

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

-Eksport import ne sektorin e perpunimit aktiv - Import-eksport, dhe perpunim guri,mermeri,graniti, tregtim me shumice e pakice i gurit,mermerit,granitit dhe materialeve te ndertimit, ,tregtim dhe transportimin i materialeve inerte si: rera,zhavore,gure,çakull,gelqere,granile dhe materiale te ndryshme per ndertim, Prerje blloku mermeri,guri,graniti, tregtim i nenprodukteve te mermerit dhe granitit , Tregtim me pakice dhe shumice i lastrave te mermerit dhe granitit si dhe Import-eksport i tyre sipas kerkeses,ndertime,rikonstruksione,ndertime godina banimi shume kateshe,ndertim vila,pallate, rruge,punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge,punim restaurimi te ndertesave te ndryshme., e qe konsiderohet i pershtatshem per rritjen dhe zhvillimin e metejshem te aktivitetit te shoqerise. Blerje shitje automjete e motomjete. Mjete dhe motomjete me qera.

AKT THEMELIMI DHE STATUT “T.R.E 222 Construction” SHPK

Import, export shitje materiale dhe vegla pune te ndryshme ndërtimi dhe industriale. Import, export shitje materiale te ndryshme elektro-shtepiake dhe aksesori e sisteme elektronike

Tregtim me shumice dhe pakice, import-eksport, i artikujve te ndryshem industrial, ushqimore, konfeksione, makineri dhe pajisje, te pajisjeve elektro-shtepiake, hidro-sanitare transport per vete dhe te trete. Import, shit-blerje automjetesh. Ndertime rruge, autostrada ndertesa rikonstruksione, punime/germime dhe sistemime dheu, tarracime, terrenesh, rikonstruksion godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, ndertime urash dhe konstruksione metalike, montime panelesh, ndertime terrenesh, ndertime rruges, asfaltime, hapje kanalesh si dhe çdo ndertim tjeter me karakter civil dhe ekonomik si hapje kanalizime, ndertim ujesjellesash, etj. Prodhim e tregtim me shumice e pakice te materiale inerte si beton, asfalto-beton etj. Shtrime rruges dhe riparime me beton, asfalto beton ose material te tjera te perdorura per kete qellim. Projektim dhe instalim i impianteve e pajisjeve elektrike, elektroshtepiake, pajisje laboratorike, industriale, sistemeve te ftohjes e ngrohjes (kondicionimit) si dhe impianteve te tjera te cfaredo lloji ne vendet e ushtrimit te aktivitetit dhe jashte tyre ne objekte te ndryshme. Shërbime mirembajtje dhe servisi te ndryshem per materiale e pajisje elektrike, pajisje industriale e elektroshtepiake, pajisje laboratorike, pajisje dhe sisteme te ftohjes e ngrohjes (kondicionimit) si dhe per impiante te tjera te cfaredo lloji ne vendet e ushtrimit te aktivitetit dhe jashte tyre ne objekte te ndryshme. aktivitetin ne fushen e ndertimit, studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimin dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: punimin dhe germimin ne toke, ndertimin e ndertesave civile dhe industriale publike ose private, centraleve dhe objekteve turistike, objekteve te kultit, rrjetet inxhinierike, objektet industriale, te gjitha restaurimet dhe rikonstruksionet dhe mirembajtjet e godinave civile e industriale, veshje e fasadave ne pergjithesi; ndertimin dhe rikonstruksionin e rrugeve, autostradave, mbikalimeve, hekurudha e tramvai, metrove e pistave aeroportuale;

Projektim dhe zbatim i veprave ndertimore si vijon: ndertime me karakter civil dhe ekonomik, punime/germime dhe sistemime dheu, tarracime, terrenesh, rikonstruksion godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, ndertime urash dhe konstruksione metalike, montime panelesh, ndertime terrenesh, ndertime rruges, asfaltime, hapje kanalesh si dhe çdo ndertim tjeter me karakter civil dhe ekonomik si hapje kanalizime, ndertim ujesjellesash, etj. Projektim dhe ndertim e mirembajtje lulishte apo kopshte bimesh. Prodhim e tregtim me shumice e pakice te materiale inerte si beton, asfalto-beton etj. Shtrime rruges dhe riparime me beton, asfalto beton ose material te tjera te perdorura per kete qellim. Ndertim dhe shtrirje te rrjeteve te gazit natyror. Zhvillimi dhe ndermjetesimi i projekteve per rikonstruksionin e ndermarrjeve

AKT THEMELIMI DHE STATUT “T.R.E 222 Construction” SHPK

industrial. Sigurimi i projekteve industrial, ashtu si edhe strukturimi i kontratave afatgjata per levrimë dhe mbi bazën e këtij rifinancimi dhe kreditimi, ndërmjetesimi, nxjerrja dhe perpunimi i lendeve të paratë përdorura për ndërtim të të gjitha llojeve dhe veprimtari shërbimi për llogari të personave të tretë. Prodhim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të materialeve të ndërtimit import eksport të tyre Brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë si dhe të tregëve ku përfshihen inerte, gurë, gurë dekorative, gëlqerë, pllaka parafabrikate, llaç, çimento, rërë, granitë të fraksioneve të ndryshme si dhe çdo material tjetër që nuk është përmendur këtu për përdoret në fushën e ndërtimit. Tregtim me shumicë e pakicë të mallrave ushqimore, industrial, pajisje elektroshtepiake, produkte bujqësore dhe blegtorale, konfeksione pajisje elektroshtepiake, pjesë këmbimi etj. Veprimtari në fushën e transportit të mallrave brenda dhe jashtë vendit me mallrat e vetë shoqërisë dhe të tregëve. Tregtim me shumicë dhe pakicë të mallrave industrial, ushqimore, bujqësore, blegtorale, elektroshtepiake ushqimore social etj. Importimi,, eksportimi i produkteve të gatshme dhe gjysem të gatshme si dhe të lendeve të para për të si dhe kontraktimi me persona të ndryshëm fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj për këto qëllime; Tregtimi me shumicë e me pakicë të pijeve alkoolike, artikuj prej druri, makineri e pajisje si dhe pjesë këmbimi të tyre.

-Eksport import në sektorin e perpunimit aktiv - Import-eksport, dhe perpunim gurë,mermeri,graniti, tregtim me shumicë e pakicë të gurit,mermerit,granitit dhe materialeve të ndërtimit, ,tregtim dhe transportimin të materialeve inerte si: rërë,zhavorë,gurë,çakull,gëlqerë,granitë dhe materiale të ndryshme për ndërtim, Prerje blloku mermeri,gurë,graniti, tregtim të nënprodukteve të mermerit dhe granitit , Tregtim me pakicë dhe shumicë të lastrave të mermerit dhe granitit si dhe Import-eksport të tyre sipas kërkesës,ndërtimë,rikonstruksione,ndërtimë godina banimi shumëkateshe,ndërtim vilë,pallatë, rrugë,punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë,punim restaurimi të ndërtesave të ndryshme., e që konsiderohet të përshtatshëm për rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit të shoqërisë. Blerje shitje automjete e motomjete. Mjete dhe motomjete me qera. Import, export shitje materiale dhe vegla pune të ndryshme ndërtimi dhe industriale. Import, export shitje materiale të ndryshme elektro-shtepiake dhe aksesori të sistemeve elektronike

Neni 3

Kohëzgjatja

Jetëgjatësia e shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar.

Neni 4:

AKT THEMELIMI DHE STATUT “T.R.E 222 Construction” SHPK

Selia

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Beltoje , shkoder**
Zyra rregjistrimit Shkoder,
Z-K nr: 1148, Nr-Pasurie: 84/12 Volumi/4 Faqe/ 128 , Beltoje
- (2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:
paplekakristian@gmail.com

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **1, 000 ,000 Lekë** (1 milion leke)
- (2) Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a. Ortaku: **Z. Ernest Rranzi** Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën **45%** të kapitalit themeltar të shoqërisë(450 000Leke)
 - b. Ortaku **Z. Aleksandër Zefi** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën **45 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë(450 000Leke)
 - c. Ortaku **Z. Kristjan Paplekaj** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën **10 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë(100 000Leke)

Kontributi I ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë(pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi I kapitalit

AKT THEMELIMI DHE STATUT “T.R.E 222 Construction” SHPK

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shit-blerjes;
- c) Trashigimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Kreu III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

AKT THEMELIMI DHE STATUT “T.R.E 222 Construction” SHPK

Organi vendimmarrës

Ortakët e shoqërisë janë organet e vetme vendimmarres të shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë janë organet e vetme vendimmarres të shoqërisë që miratojnë çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Ortakët janë përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emerimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) Emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
- f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së verimtarisë;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

Cdo ndryshim i statutit rregjistrohet sipas ligjit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

AKT THEMELIMI DHE STATUT "T.R.E 222 Construction" SHPK

Neni 9 Administrimi

- (1) Ortaket emërojnë një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Cdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:

- ❖ **Z. Kristjan Papekaj** shtetas Shqiptar, lindur me **14.05.1995 Shkoder**, banues në Shqipëri, identifikuar me numrin e kartës së identitetit nr **J50514101V**

Neni 10 Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë;
 - Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - Kryejnë rregjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare, dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

AKT THEMELIMI DHE STATUT “T.R.E 222 Construction” SHPK

- Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- Administratores janë të detyruar të thërrasin asamblene e përgjithshme në rastet kur:
- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare,rezulton ose ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk l mbulojnë detyrimet e kërkueshme brënda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë një mënyrë tjetër active,të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë,që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara..

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se 1 administrator ,ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë me shumicë të zakonshme.Paditë që lidhen me shpqrblimin e administratorit ,në bazë të mardhënieve kontraktore me shoqërinë,rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 11

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht,ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve,për shkelje të ligjeve,për shkelje të statutit,apo për faje te kryera gjatë administrimit të shoqërisë.Pasojat e marrëveshjeve te pamiratuara nga asambleja që l sjellin dëm shoqërisë,l ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bërë marrveshjen,për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht,sipas rastit,pasojat përkatëse

Pervec sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë,sipas neneve 14,15,17 e 18 të ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”,administrator detyrohet;

1.

- a) Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara ne ligj dhe ne statut në mirëbesimin dhe interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi,duke l kushtuar vëmëndje të veçante ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) Te ushtrojë kompetencatqë l njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) Të vlerësojë me përgjegjësi çeshtjet,për të cilat merret vendimi;
- d) Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit,present apo të mundshëm,të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

AKT THEMELIMI DHE STATUT “T.R.E 222 Construction” SHPK

2.Administratori,gjatë kryerjes së detyrave të tij,përgjigjen ndaj shoqërisë për cdo veprim apo mosveprim,që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare,me përjashtim të rasteve kur,në bazë të hetimit dhe vlersimit të informacioneve përkatëse,veprimi ose mosveprimi është kryer ne mirëbesim.

3.Nëse administrator vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale,sipas pikave 1 e 2 të këtij neni,është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet,që rrjedhin nga kryerja e shkeljes,si dhe ti kaloje çdo fitim personal që ata apo përsnat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.Administratori ka barren e proves për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara.Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator,ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4.Në mënyrë të veçantë por pa u kufizuar në to,administrator është i detyruar ti dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara,nëse,në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”,kryen veprimet e mëposhtme;

- a) U kthen ortakëve kontributet
- b) U paguan ortakëve interest apo dividendë;
- c) U shpërndanë aktivet shoqërisë;
- d) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare,kur,në bazë të gjëndjës financiare,duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishtë aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit,ortakët individualisht ose së bashku,kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkatuar shoqërisë,përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar,nëse është e nevojshme.Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit të detyrës

Kreu IV

VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 12

AKT THEMELIMI DHE STATUT “T.R.E 222 Construction” SHPK

Viti financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjatë viti i parë fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara të cilat është i detyruar, që t’ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve, për t’i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendore që ka.

KREU V

PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISE

Neni 14

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) Me vendim të asamblesë së ortakëve;
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”
- e) Me vendim të gjykatës;

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë, mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”

Prishja e shoqërive tregtare ka sipasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortakët.

AKT THEMELIMI DHE STATUT "T.R.E 222 Construction" SHPK

Nëse oratkët nuk marrin një vendim për emërimin e likujduesve, brënda 30 ditëve pas prishjes, cdo person i interesuar, mund të drejtohet gjykates, për të caktuar nje likuidues.

Neni 15

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara ne pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 16

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe cfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 17


Mosmarrveshjet

Për mosmarrveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute, si dhe për çdo mosmarrveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKET E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR.

Z. Kristjan Paplekaj

(Administratori)


(nënshkrimi)

Aleksandër Zefi


(nënshkrimi)

Z. Ernest Rranzi


(nënshkrimi)